

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE "SYNTECH" SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe atij nr.9723,date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar, me vullnetin tim te lire, une:

- **Feim Hoxha** , i biri i Skenderit, shtetas Shqiptar , lindur ne Burrel, me 02/03/1960 e banues ne Rruga Karl Gega, Nd 11 Ap 8, Tirane, me Karte ID Nr personal: G00302096V.

madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar shpall si vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar "**SYNTECH**" Sh.p.k me ortak themelues:

- **z. Feim Hoxha**

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesve te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne, **Rruga "Karl Gega", Nd 11, H7 Ap 8 Tirane**. Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi e agjensi operative ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Objekti i veprimtarise do te jete:

Tregtim me shumicë dhe pakicë te vajrave dhe produkteve lubrifikante dhe pjeseve te kembimit per automjete.

Ortakët e shoqërisë bien dakort që aktivitetet e mësipërme do të fillojnë pasi shoqëria të pajiset me licensat përkatëse.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **200.000 (Dyqindmije) leke** dhe perbehet nga 1 kuota me kontributet e ortakut si me poshte:

- z. Feim Hoxha 200.000 leke, 1 kuote ose 100% te kapitalit

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht.

Ndryshimet e kuotave mund te arrihen nepermjet kontributeve ne kapitalin e shoqerise ose me shitblerje.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortaku mund ti shesi te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim ortakut.

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.

- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

NENI 10

Administratori i shoqerise "**SYNTECH**" Shpk emerohet z. **Feim Hoxha** me afat 5 vjet.

NENI 11

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksioneve financiare do te kryhen ne baze te kriterave te caktuara nga Banka e Shqiperise. Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdorim ortakeve, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi i reserves ligjore.

NENI 13



Ky akt u perpilua ne prani te ortakut duke shprehur vullnetin e tij te plote e te lire.
Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, per t'u depozituar ne
Qendren Kombetare te Regjistrimit, Tirane e per t'u shperndare ne organet
kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

Tirane me 02.06.2025

ORTAKET THEMELUES

Feim Hoxha

